

BULETIN MUJOR



Çelen thirrjet për projekte të kërkimit shkencor

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka hapur 3 thirrjet e reja për vitin 2026 për: Projektet e kërkimit shkencor dhe zhvillimit; Projektet e teknologjisë dhe inovacionit; Projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor; duke u dhënë mundësinë të gjitha universiteteve, njësive të kërkimit shkencor dhe kërkuesve shkencorë të vendosin piketat për projektet e ardhshme në programet e tyre. Ministria e Arsimit ka vendosur 7 milion euro buxhet si mbështetje për kërkimin shkencor dhe inovacionin.




Mbështetje financiare me pagë minimale për 444 studentë ekselentë dhe programeve prioritare

Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë do të mbështesin 444 studentë ekselentë dhe të programeve prioritare në vitin akademik 2025–2026, duke i përjashtuar nga tarifat e studimit dhe me pagën minimale prej 50 mijë lekë në muaj. Nga këta, 166 janë studentë ekselentë dhe 278 ndjekin programe prioritare, duke reflektuar një orientim të qartë drejt fushave kyçe për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit.



Mësimi i shqipes në Diasporë i standardizuar dhe certifikuar

U mbajt në mjediset e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë aktiviteti “Gjuha shqipe si politikë shtetërore: standardizimi dhe certifikimi në diasporë”. Në këtë aktivitet, ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro shpalli hyrjen në një fazë të re të Qendrës së Botimeve të Diasporës, që garanton mësimin e gjuhës amtare në mënyrë të qëndrueshme, të standardizuar dhe certifikuar, si institucioni referencë për ngritjen e Agjencisë Kombëtare për Gjuhën Shqipe në Diasporë, për të cilën është ndërtuar dhe një kalendar pune që nis me rishikimin e ligjit brenda vitit 2026.



Shqipëria merr pjesë me 180 shkolla në testimin ndërkombëtar PIRLS 2026

Shqipëria do të përfaqësohet në testimin ndërkombëtar PIRLS me 180 shkolla gjatë muajit mars. Ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro ka zhvilluar një takim pune me drejtuesit e Zyrave Vendore, në vijim të përgatitjeve. PIRLS është një vlerësim ndërkombëtar që mat aftësinë e nxënësve 10-vjeçarë për të lexuar dhe kuptuar tekstin, ndërsa këtë vit vendi ynë do të marrë pjesë për herë të parë në mënyrë plotësisht digjitale. PIRLS, i cili kryhet çdo pesë vjet që nga viti 2001, njihet si standardi global për vlerësimin e trendeve në arritjet në lexim në klasën e katërt.



Zgjidhen drejtuesit e rinj të Parlamentit të Nxënësve

Përmes një seance të veçantë në Kuvendin e Shqipërisë u zgjodhën drejtuesit e rinj të Legjislaturës IV të Parlamentit të Nxënësve. Ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro përshëndeti seancën, duke kërkuar nga përfaqësuesit e rinj të këtij parlamenti të jenë zë i shqetësimeve, sfidave dhe pritshmërive të bashkëmoshatarëve të tyre të shkollave të Shqipërisë. Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë është organi përfaqësues i qeverive të nxënësve në nivel kombëtar, me qëllim forcimin e pjesëmarrjes aktive të qeverisë së nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Shqipërisë në proceset e vendimmarrjes dhe në rritjen e cilësisë së arsimit.



Në vitin e ri shkollor do të nisë zbatimi i kurrikulës së re me 171 tekste

Nga shtatori 2026 nis zbatimi i kurrikulës së re në arsimin parauniversitar, duke përfshirë fillimisht klasat I, VI dhe X. Reforma do të shtrihet gradualisht në të gjitha nivelet deri në vitin 2029, kur procesi pritët të përmbyllet plotësisht, duke përfshirë edhe klasat IV, V dhe IX. Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, prezantoi vizionin e rishikimit të paketës kurrikulare, që përfshin kurrikulat bërthamë dhe programet lëndore për klasat përkatëse. Në kuadër të zbatimit është përgatitur lista për përditësimin e 171 teksteve shkollore, nga të cilat 140 janë fizike dhe 31 digjitale.